

PAKTI KUNDËR KORRUPSIONIT

Preambula

Ne, drejtuesit e subjekteve politike në garë për pushtet, përmes zgjedhjeve të lira të 6 Tetorit, 2019, të vetëdijshëm për përgjegjësinë politike dhe institucionale, të gatshëm për t'i ofruar Republikës së Kosovës një qeverisje efikase, të përgjegjshme dhe me integritet e legjitimitet të plotë vendimmarrës, të vetëdijshëm për dëmet kapitale që shkakton korrupsioni dhe abuzimi me pushtetin, të vendosur për luftë të pa kompromis kundër korrupsionit dhe abuzimit, unanimisht vendosim këtë Pakt Kundër Korrupsionit, si orientim e vendosmëri për të qeverisur me integritet të plotë.

Institucionet e Republikës së Kosovës dhe rendi demokratik i saj, janë konsoliduar mbi parimet ligjore dhe standardet më të larta për një politikë të mirëfilltë të përfaqësimit dhe misioni i tyre themelor është administrimi i përgjegjshëm dhe efikas në shërbim të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Republika e Kosovës, përgjatë dy dekadave të fundit, e veçmas pas pavarësisë, ka qenë e ekspozuar para një tranzicioni të qeverisjes, rrjedhimisht, institucionet tona kanë qenë të ekspozuara para dukurive që kanë sfiduar ndërtimin e shtetit ligjor, në mesin e të cilave korrupsioni, keqpërdorimi i detyrës zyrtare, abuzimi me pushtetin publik dhe elementet tjera përcjellëse si punë zënia mbi baza familjare, partiake dhe politike.

Ky realitet, është dëshmuar i dëmshëm për cilësinë e jetës së qytetarëve tanë, për zbatimin e parimeve të një ekonomie të lirë të tregut, për zbatimin e parimeve kushtetuese të sundimit të ligjit dhe barazisë para tij, si dhe për vetë imazhin e Republikës së Kosovës përballë qytetarëve dhe partnerëve tanë.

Një gjendje e tillë nuk mund të tolerohet në asnjë rrethanë dhe për asnjë çast. Është koha që tranzicioni të përmbillet dhe t'i krijojë hapësirë një epoke të re në të cilën, institucionet

tona të jenë tërësisht të përgjegjshme, efikase, llogaridhënëse dhe në zbatim konstant të përgjegjësi të tyre ligjore përballë qytetarëve.

Për ta stimuluar një shkëputje përfundimtare nga kultura e abuzimit, Ne, subjektet politike e konsiderojmë si hap të domosdoshëm integritetin politik, të shprehur përmes këtij pakti kundër korrupsionit, elementet qendrore të së cilit përfshijnë:

1. Mos kandidimi i personave të akuzuar për korrupsion

Ne marrim përsipër që në këto zgjedhje të vendosim një standard të ri të integritetit politik, duke pamundësuar kandidimin për përfaqësues të popullit nga radhët tona, të personave të akuzuar për korrupsion. Ne konsiderojmë se mënyra më e mirë e shprehjes së vullnetit politik për luftë kundër korrupsionit dhe abuzimit, është ofrimi i kandidatëve politik, mbi të cilët nuk rendon ballafaqimi me ligjin në sferën që prek dyshimet për korrupsion apo abuzim me pushtetin. Mbi këtë bazë, Ne do të ofrojmë një listë të kandidatëve për deputetë, të cilët janë kompetent, profesionistë dhe për të cilët nuk ka dyshim të vërtetuar për afera korruptive.

2. Mos emërimi në pozita publike i personave që kanë rënë ndesh me ligjin në sferën që prekë korrupsionin apo abuzimin me pushtetin

Ne konsiderojmë se përveç mos kandidimit për deputet të personave mbi të cilët ka dyshim, personat që kanë rënë ndesh me ligjin, nuk mund të emërohen në pozitat ekzekutive, përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në: Ministrat, Zëvendëskryeministrat, Zëvendësministrat, Këshilltarët Politik, si dhe asnjë pozitë tjetër që emërohet me vendim nga Qeveria.

3. Suspendimi i zyrtarëve të akuzuar për korrupsion

Ne jemi të bindur se lufta kundër korrupsionit nuk mund të zhvillohet vetëm në nivelin e sistemit të drejtësisë, por mund dhe duhet të zhvillohet edhe përmes politikave të qeverisjes së mirë. Prandaj, jemi të vendosur që këtë vullnet politik për ta luftuar korrupsionin ta përqendrojmë në sanimin e kulturës abuzive, duke respektuar sundimin e ligjit, barazinë dhe ligjshmërinë. Ndër masat e para për të cilën Ne zotohemi përmes këtij pakti kundër korrupsionit, është vendosmëria për të përmbushur politikën e suspendimit të zyrtarëve të akuzuar për korrupsion, pa paragjykuar epilogun e drejtësisë.

4. Mbrojtja e interesit publik

Ne konsiderojmë se parandalimi dhe luftimi i korrupsionit, përveç karakterit penal, duhet të ketë edhe karakter të mbrojtjes së interesit publik dhe buxhetit të taksapaguesve të Republikës së Kosovës. Ne zotohemi se nuk do të ndërmarrim, mbështesim, promovojmë asnjë vendim, veprim apo përcaktim elektoral të politikave që cenojnë interesin publik të qytetarëve dhe shoqërisë në përgjithësi.

5. Parandalimi i korrupsionit pasiv

Ne konsiderojmë se secili nga ne ka përgjegjësi për veprim politik kundër korrupsionit, por edhe përgjegjësi për mos veprim kundër korrupsionit. Përmes këtij Pakti, Ne zotohemi se do të sfidojmë kulturën e pasivitetit, pajtueshmërisë dhe mosndëshkimit të veprave të korrupsionit dhe abuzimit, kudo që ka indice për to.

6. Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit politik

Ne konsiderojmë se krahas luftës kundër korrupsionit në rrafshin penal që është përgjegjësi e organeve të pavarura të zbatimit të ligjit, do të ekspozojmë publikisht dhe bëjmë thirrje për luftimin e korrupsionit politik, i cili vjen në formë të nismave ligjore,

rregulloreve, vendimeve dhe orientimit të buxhetit mbi stimujt korruptiv dhe për motive korrupsioni.

7. Transparenca e emërimeve të pozitive të larta drejtuese

Ne zotohemi për transparencë të plotë të emërimeve të personave në pozitat e larta drejtuese brenda institucioneve, bordeve, agjencive ekzekutive dhe çdo emërimi që rezulton nga vendimi i Qeverisë apo Kuvendit të Republikës së Kosovës.

8. Ndëshkimi i nxitësve të korrupsionit

Ne konsiderojmë se korrupsioni dhe abuzimi nuk janë të njëanshëm dhe se ato kanë stimuluesit e tyre, si brenda sferës institucionale ashtu edhe jashtë saj. Përmes këtij Pakti, Ne zotohemi se brenda përgjegjësive institucionale e politike që mbajmë varësisht nga pesha politike që derivon nga zgjedhjet e lira, përmes Listës së Zezë së akterëve të korrupsionit, do të distancojmë nga përfitimi i buxhetit të taksapaguesve të Republikës së Kosovës, çdo kompani, biznes individual, apo entitet tjetër juridik që është përfshirë në afëra korruptive.

9. Sinjalizimi kundër korrupsionit

Ne, drejtuesit e subjekteve politike, jemi të bindur se kultura politike, shtet formuese dhe institucionale duhet ta marrë në mbrojtje secilin qytetar, zyrtar, komunitet dhe institucion publik, që sinjalizon korrupsionin, abuzimin dhe keqpërdorimin e pushtetit në secilin nivel, qoftë ajo përvojë personale brenda vendit të punës, posedim i dëshmive përkatëse, apo përpjekje e organizuar për përfitim të paligjshëm nga ana e zyrtarëve politik që ushtrojnë funksione publike. Përmes këtij pakti, Ne marrim përsipër që brenda kompetencave politike dhe institucionale që drejtojmë, të angazhohemi për mbrojtje dhe respektim të sinjalizuesve kundër korrupsionit dhe abuzimit.

10. Standardi i integritetit të pushtetit politik

Ne, drejtuesit e subjekteve politike, të vetëdijshëm se parimet e këtij Pakti, paraqesin një standard të ri të integritetit gjatë ushtrimit të pushtetit politik, zotohemi se bazën e këtij Pakti, si nismë të domosdoshme për të fuqizuar besimin e qytetarëve në institucionet publike, në partitë politike dhe në përgjegjësinë e pushtetit politik do ta zbatojmë në çdo nivel. Përkushtimin në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimit, përkatësisht, standardin e ri që po vendosim do ta zbatojmë jo vetëm në pushtetin qendror por edhe në nivelin e pushtetit lokal në kuptim të emërimit të si në vijim:

- a) Kandidatëve për Kryetar të Komunave;
- b) Kandidatëve për Asamble Komunale;
- c) Drejtorëve të Drejtorive Komunale;
- d) Çdo të zgjedhuri tjetër; ku ndaj të lartcekurve do të vlejnjë të gjitha parimet e këtij Pakti, duke filluar nga sot e tutje.

Ne, drejtuesit e poshtëshënuar të subjekteve politike në garë për zgjedhjet e parakohshme, marrim përsipër përgjegjësinë e plotë politike dhe institucionale për zbatimin e secilës pikë nga Pakti Kundër Korrupsionit.

Kadri Veseli

Kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës

